


REXHEP
TËRSHNJAKU

Kush e vrau ujkun

DRAMË PËR FËMIJË



Rexhep Tërshnjaku

Rexhep Tërshnjaku

KUSH E VRAU UKUN

Dramë për fëmijë

„Branie per jsem jen...“
Viktor (Ondřej Vlček) vystudoval na FAMU, kde vystudoval
jeho mědiální, později hudební a rovněž pate hudebnostní fakultu.
Je členem skupiny „Květy“.

**CITTÀ di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
*Vincenzo Cucci***



RILINDIA

Prishtinë

Biblioteka

D R A M A

Redaktor

Dr. Nebi Islami

Recensent

Fadil Hysaj

Lektor

Isa Bajçinca

Ilustrimet

Ardeshir Tërshnjaku

Ballina

Rrezeart Galica

© Copyright autori

PERSONAZHET

**Ujku, Dhia, Keci I, Keci II, Keci III, Keci IV,
Keci V (i vogël dhe i madh), Mullisi, Zana e pyllit.**

AKTI – I –

(*Skena ndriçohet. Pamje pylli. Në thellësi të skenës, një përroskë. Dëgjohet gurgullima e ujit, e përzier me cicërimën e zogjve. Nga ana e majtë e skenës hyn duke kërcyer një Kec i vogël. Afrohet buzë përroskës dhe fillon të pijë ujin. Nga ana tjetër hyn ujku duke i lëpirë buzët dhe duke fërkuar duart. I afrohet përroskës dhe bën sikur pi ujin).*

Ujku (I zemëruar): Hej bebi pse po ma turbullon ujin?

Keci (I trembur): O zotëri, si mund t'jua turbulloj ujin, kur jam më poshtë se ju!?

Ujku (Qesh me ironi): Ha, ha, ha. Mirë, mirë, tash vërtet je më poshtë, por më kujtohet se ma pate turbulluar ujin vitin e kaluar.

Keci: O zotëri, po unë jam i lindur sivjet. Si kam mundur t'ua turbulloj ujin, kur vjet nuk kam qenë në jetë. (*Rrudh krahët i çuditur*) Jo. Për këta katër muaj jete, sa kam, askujt nuk ia kam turbulluar ujin.

Ujku (I millefoser i drejtobet me zemërim): More s'po të pyes a ke lindur vjet apo sivjet, por e di me siguri se mishin e ke të shijshëm (*i vërsulet që ta kollofisë*).

Keci (Nga frika, struket dhe lëshon një blegërimë të dridhëruar): Të luttem moos... mmos më haa!

Ujku (E frenon veten, nuk do ta kollofisë. Flet me zë të ulët): Vërtet është i vogël sa një gogël. Do të ta fal jetën nëse më plotëson një dëshirë. (*Dhe fillon ta ledhatojë Kecin, që rri ende struktur*). Hej bebi!

ПЕРСОНАЖ

Вибір макету, який ви виберете
Університет, Медичний коледж, Медичний
Завод або Спеціалізований
Інститут



Ngijynos

Keci (*Pa e ngritur kokën*): Hë!

Ujku (*Me dinakéri*): A ke vellezér tē tjerë?

Keci (*E ngre kokën dhe ofshan thellë. I hutuar*): Uhaa?

Çfarë? Si?

Ujku (*E përsërit me zë*): A ke vellezér tē tjerë?

Keci: Po, kam edhe katër vellezér.

Ujku (*Qeshet me dinakéri*): Ha, ha! Po pse nuk më tre-gove më herët?

Keci (*I rrudh krahët*): S'më keni pyetur!

Ujku: A e di çfarë?

Keci (*Kureshtar*): Çfarë?

Ujku: Unë nuk do tē tē ha ty dhe do tē bëhem miq.

Keci (*Kërcen nga gëzimi*): Uaa! Ju falemnderit, xhaxhi. Do tē mbetemi miq sa tē jetë jeta!

Ujku (*Me dinakéri*): Miq po, por mikut – e mira i kthehet me tē mirë. Prandaj nga ti kërkoj që këtë tē mirë që ta bëra sot, tē ma kthesht nesër, me ndonjë tē mirë tjetër.

Keci: Po xhaxhi. (*I habitur*) Çfarë tē mire kérkon nga unë?!

Ujku: Një tē mirë tē vogël.

Keci (*Kureshtar*): Folni, zotëri. Po tē jetë e mundur, jua jap besën se do t'jua plotësoj atë dëshirë, menjëherë.

Ujku: Nga ti dua që, kur tē vij në kasollen tuaj, tē ma hapseh derën, kuptohet, si miku–mikut.

Keci (*I çuditur*): Vetëm kaq??

Ujku (*Duke luajtur kokën*): Kaq, dhe asgjë më tepër.

Keci: Po, do tē ishte turp për mua po tē mos i hapja derën mikut tim.

Ujku (*I gëzuar*): Ashtu pra, nipçja im, e mira duhet kthyer me tē mirë. E tash mund tē shkosh.



Aqijyos

Keci: Mirupafshim, miku im! (*Dhe ikën nga skena i gëzuar, duke kërcyer*).

Ujku (*Duke ia bërë me dorë*): Mirupafshim, nipçe! (*Flet me vete me zë të ulët*). Oh, ho, ho, më mirë pesë se një, nuk jam budalla unë, jo! (*Dhe duke fërkuar duart e duke lëpirë buzët, ikën duke mërmëritur me vete. Skena errësohet nën gurgullimën e ujit*).

AKTI – II –

(*Skena ndriçohet. Është kasollja e kecave. Në anën e djathtë të skenës, dritarja e kasolles. Në mur, e varur një orë e madhe muri. Nga jashtë dëgjohet blegërima e kecave. Hapet dera e kasolles dhe katër keca hyjnë brenda*).

Dhia (*Hyn duke i numëruar kecat. E habitur*): Ku mbeti sugari? (*Kecat, të habitur, shikohen në mes veti*).

Keci I (*I çuditur*): Vërtet, ku na humbi sugari? !

Keci III (*Duke menduar*): Vallë, mos është rrëzuar nga ndonjë shkë...?!

Keci IV (*Ia pret fjalën*): Jo jo, mos ndill kob, se sugari është më i shkathtë se të gjithë ne, prandaj nuk i ndodh gjë.

Keci II: Unë e di (*dhe kruan kokën*).

Dhia: Hë, fol ku është?

Keci II: Mua më tha se kishte etje. Me siguri ka shkuar te përroska për të pirë ujë.

Keci I: Të shkojmë pra deri te përroska, e ta kërkojmë sepse është i vogël dhe mund ta humbasë rrugën.

Keci IV (*Duke bërë me gisht nga dritarja. I gëzuar*): Ja tek vjen. (*Të gjithë e kthejnë kokën dhe shikojnë nga dritarja. Keci V vjen duke vrapiuar e kërcyer*).

Ngjyros



Dhia (*Del nga kasollja e zemëruar. Dialogu dëgjohet nga jashtë*): Ku qe deri tani?

Keci V: Shkova për të pirë ujë te përroska e pyllit!

Dhia: Përse ike pa na lajmëruar?

Keci V: Më fal nënë, paskam gabuar...

Dhia (*Ia pret fjalën*): Të qoftë falë, eja tash, hyn brenda. (*Të dy hyjnë në kasolle. Dhia e shikon orën e murit. E çuditur*). Ua! Ora paska kaluar dymbëdhjetë, është koha e bukës e ne s'kemi asgjë për të shtruar në sofër. Shkova deri në treg për të blerë diçka. Mbylleni derën me çelës. Unë nuk do të vonohem shumë.

Keci I (*I frikësuar*): E ne si të qëndrojmë pa ty?

Dhia: Mos u frikësoni. Nëse troket ndokush, mos ia hapni derën pa ia parë këmbën nëpër vrimën e çelësit. Nëse e ka këmbën të zezë, do të ujku, dhe keni kujdes të mos ia hapni derën. Nëse këmba është e bardhë, hapeni, se jam unë, a kuptuat?


Keci I: Të kuptuam, nënë, derën do ta mbyllim me çelës dhe nuk do t'ia çelim askujt që nuk e ka këmbën të bardhë.

Dhia: Mirë, pra, unë po shkoj e ju mos bëni zhurmë. (*Dhe del duke i përshëndetur me dorë*) Pa-pa, pa-pa.

Kecat (*Ia bëjnë me dorë*): Pa-pa! Pa-pa! (*Pastaj Keci I e mbyll derën me çelës, dhe, pa një pa dy, të gjithë fillojnë të luajnë e të kërcejnë në kasolle, duke harruar se nëna i porositi që të mos bënin zhurmë. Në momentin kur kecat janë në kulmin e lojës, dikush troket në derë: tak, tak, tak! Kecat ndalen*).

Keci I (*Afrohet tek dera*): Kush është?

Ujku: Hapma derën, jam nëna juaj.



Najyros

Keci I: Jo jo, ti nuk je nëna jonë (*dhe aftron syrin në vrimë të çelësit*). Çoje këmbën ta shohë nëpër vrimën e çelësit. Jo, jo, ti nuk je nëna jonë, ti je ujku, sepse këmbën e ke të zezë dhe zërin të trashë.

Ujku (I zemëruar): Si? ...çfarë? (*Dëgjohen hapat e rëndë të ujkut që ikën me vrap. Kecat vazhdojnë lojën. Skena errësohet*).

Pamja – II–

(*Skëna ndriçohet. Është pamje e mullirit. Shihet mullisi me rroba të përmuellura, duke paluar thasët e miellit. Dëgjohet zhurma e gurit të mullirit. Ujku hyn me vrap në drejtim të mullisit. Mullisi frikësohet*).

Ujku (Duke dihatur): Dua të më bëni një shërbim!

Mullisi (I frikësuar): Urdhëronni, çfarë, çfaarë ddoni ngga uunë?

Ujku: Të ma lyesh këmbën me miell ose të hëngra.

Mullisi: Jo, jo mmos më haa, lyeje këmbën me mmiell, vetëm moos më ha!

Ujku (I zemëruar): Unë nuk di ta lyej këmbën, por dua që të ma lyesh ti. Më shpejt se nuk kam kohë.

Mullisi: Siurdhëronni, zzotëéri, meenjëëherë! (*e mbush një enë me miell dhe i afrohet ujku duke u dridhur nga frika. Ujku e ngrë këmbën e parë dhe mullisi fillon t'ia lyejë me miell*).

Ujku: Mjaft më! A do ndonjë shpërblim për këtë të mirë që më bëre?

Mullisi (Duke u dridhur nga frika): Jjo jjo, ssepse aas që di sse çffarë shpërbllimi të kërkkoj.

Ujku (Me ironi): A shpërblim i vogël po të duket që nuk po të ha, a? (*Ikën me vrap duke u zgërdhirë*).



Najiyev

Mullisi (*Ofshan thellë dhe ulet mbi një thes*): Uh, kësaj radhe shpëtova lehtë, nga kjo bishë e egër. (*E merr shishen dhe pi ujë. Pastaj e lan fytyrën. Fillon të sillet nëpër mulli mendueshëm*). Ajo bishë e egër duhet të ketë ndonjë arsyё të fortë që më kërcënoi për t'ia lyer këmbën me miell. (*Fillon të kërkøjë diçka nëpër thasë. Nxjerr nga thesi një pushkë*). Do t'ia tregoj unë atij. S'durohet më. Do ta vrás atë bishë të mallkuar. (*E fshin pushkën dhe e mbush me fishekë. Shpejt e shpejt heq rrobat e mullisit, vë kapelën e gjahtarit dhe, me pushkë në dorë, del nga mulliri. Skena errësobhet nën zhurmën e gurit të mullirit*).

Pamja - III -

(*Skena ndriçohet. Është kasollja e kecave. Kecat janë duke luajtur. Dikush sérish troket në derë. Kecat e ndalin lojën dhe heshtin të frikësuar*).

Keci I (*Afrohet te dera*): Kush është?

Ujku (*Me zë të holluar*): Hapma derën , jam nëna juaj.

Keci I: Jo jo, ti nuk je nëna jonë. Çoje këmbën ta shoh (*dhe e vë syrin në vrimën të çelësit. Ujku e ngre këmbën*). S'është e mundur! (*I çuditur kthehet nga kecat e tjerë*). Këmbën e ka të bardhë! A thua vërtet është nëna?!

Keci III (*Vrapon te dera dhe shikon për vrimë të çelësit. I habitur*): Për besë, këmbën e paska të bardhë dhe zërin të hollë!

Keci IV: More, ndoshta është vërtet nëna!

Keci II: Po çfarë nëne, more. A jeni në vetc ju? Punë e madhe se e paska këmbën të bardhë e zërin të hollë. Ai është i njëjti...

Keci V (*Ia ndërpert fjalën*): Po nëna na tha, nëse është këmba e bardhë, duhet ta hapim derën. Të shikoj unë në vrimën e çelësit (*e vë syrin dhe sheh*).



Ngjyros

Keci I: Jo, jo. Nëna nuk na ka thënë që kujdo që e ka këmbën tē bardhë, t'ia hapim derën. Megjithatë, unë mendoj se duhet tē merremi vesh së bashku. (*Dhe tē gjithë kecat, përveç Kecit V që është duke shikuar në vrimën tē çelësit, afrohen kokë më kokë dhe fillojnë tē bisedojnë me zë tē ulët. Dëgjohet pëshpëritja e tyre*).

Keci V (Me sy në vrimën e çelësit, pyet me zë tē ulët): Kush je ti?!

Ujku (Nga jashtë, me zë tē ulët dhe dinakéri): Hapja derën mikut, o nipçja im. A ke harruar besën që ma ke dhënë, a?

Keci V (I trembur, largohet nga dera duke folur me zë tē ulët): Për besë qenka ai! (*Dhe fillon tē sillet nëpër kasolle duke mërmëritur fjalët e ujkut*)” A e ke harruar besën që ma ke dhënë a”...! Uh besën, besën! Ta mbaj apo tē mos e mbaj besën!? (*Dhe fillon tē sillet si pa kokë nëpër kasolle. Kecat e tjerë pasi merren vesh, tē brengosur, sillen nëpër kasolle*).

Keci IV: Unë nuk po shoh gjë tē keqe këtu. Ujku e ka këmbën tē zezë dhe zërin tē trashë, kurse ky përtej derës e ka këmbën tē bardhë dhe zërin tē hollë. Edhe nëse nuk është nëna, ujk nuk është. Ndoshta është mik yni.

Keci II (I zemëruar): Po çfarë miku more! Kur ka qenë ujku mik yni?

Keci V (I shqetësuar): Ndoshta nuk është mik yni por as ujk nuk është.

Keci II (Me zemërim): Nga e di ti se nuk është ujk?

Keci V (Indruajtur): Sepse ujku e ka këmbën tē zezë dhe zërin tē trashë, kurse ky, siç e patë edhe ju, këmbën e ka...

Keci I (Ja pret fjalën): Ngadalë, ngadalë, ne jemi vëllezër dhe nuk ka nevojë tē zihemi në mes veti. Unë kam një ide.

Keci II: Çfarë ideje tash? Hajt, fol ta dëgjojmë!

Keci I: Unë them që këtë çështje ta hedhim në vota. Le të vendos shumica.

Keci II (Me ironi): Oho! Çfarë ideje se! (*Pasi mendohet pak*). Po hajt ta shohim se si po vendos shumica.

Keci I: E pra pa vonuar, le ta ngrejë dorën ai që është kundër për të hapur derën. (*Dorën e ngrenë lart Keci II dhe vet Keci I*). Tash le ta ngrej dorën lart ai që është për ta hapur derën (dorën e ngrenë lartë Keci III, Keci IV dhe Keci V), domethënë dy janë kundër, kurse për ta hapur derën janë tre. (*Të tre kecat e vegjël brohorasin të gëzuar*) Urraaa! (*Pa një pa dy, Keci V e sjell çelësin. Dera hapet. Të gjithë kecat tmerrohen kur hyn ujku duke fërkuar duart dhe duke lëpirë buzët. Kecat, të frikësuar marrin të ikin secili nga mundet. Dëgjohet blegërima e tyre e tmerruar. Ujku, pa vështirësi e mbërtheu Kecin I. Pastaj si grykës që është gëlltiti edhe Kecin II. Pa vonuar gëlltit edhe Kecin III, pastaj pa u munduar shumë gëlltit edhe Kecin IV. Duke i fshirë buzët e duke fërkuar barkun, kërkon Kecin V, atë më të voglin. Dhe, më në fund, e gjen. Ai kishte hyrë në orën e murit. Ujku kërcen disa herë, por s'mund ta arrijë*).

Ujku (Me dinakëri): O miku im, zbrit se ty nuk të ha. A të kujtohet kur e lidhëm besën dhe u bëmë miq.

Keci V (Me mospërfillje): U pa besa jote, zotëri.

Ujku (I zemëruar): Zbrit kur të them!

Keci V: Nuk zbres, jo.

Ujku: E po deri kur do të qëndrosh në orën e murit?

Keci V: Derisa të kalojë këndeja, xhaxhi gjahtar.

Ujku (I zemëruar): Uh, i poshtër, ta tregoj qejfin ty dhe xhaxhit gjahtar. (*Kërcen edhe disa herë por s'mund ta mbërrij. Duke i lëpirë buzët dhe duke fërkuar barkun, flet me vete*): Hajt se po e lë e s'po e ha, se qenka i vogël sa një gogël (duke mërmëritur). Të largohem prej këtu sa nuk ka ardhur gjahtari.



Ngjyros

(Ikën nga kasolla me vrap duke e lënë derën e kasolles tē hapur. Skena errësohet).

Pamja – IV –

(Skena ndriçohet. Dhia hyn e trembur në kasollen e përmbysur gjithandej. Shporta e mbushur me gjësende i bie nga dora. Ajo, e shqetësuar, fillon t'i thërrasë kecat).

Dhia: Hej bebi, ku jeni? Ku keni shkuar? Ku jeni fshehur?

Keci V (Nga ora e murit): Nënë, ja ku jam.

Dhia (Vrapon dhe e nxjerr Kecin nga ora e murit. Ai e përqafon i gëzuar. Ajo e pyet e çuditur): Po ku i ke vëllezërit?

Keci V (I largohet si në vaj): I hëngri ujku!

Dhia (E trembur): Çfarë?! Si ashtu?!

Keci V (Ofshan thellë): Kur ike ti, dikush trokiti në derë dhe ne kërkuam t'ia shihnim këmbën. Këmbën e kishte të zezë dhe zérin të trashë. Kur i thamë se nuk je nëna jonë, sepse këmbën e paske të zezë, ai, i zemëruar, iku. Ne vazhduam lojën. Pas një kohe erdhi dhe trokiti prapë e na tha t'ia hapnim derën se jam nëna dhe kur ia pamë këmbën e bardhë ia hapëm derën, eëë (fillon të dënesë) Shumica vendosëm që ta hapim derën eëë... dhe unë... (duke dënesur) eëë, unë ia hapa derën.


Dhia (E tmerruar): Të ia hape derën?!

Keci V (Duke qarë): Po, nënë! E shoh që kam gabuar eëë... Më fal... (dhe dënes, eëë. Dhia e ledhaton. Pas pak Keci, duke i fshirë sytë) Nënë, si ta gjejmë ujkun e ta mbysim atë bishë.

Dhia: Mirë thua (mendueshëm), por ku mund ta gjejmë se, dhe si ta mbysim?!

Keci (Duke i fshirë lotët): Nënë, ta thërrasim xhaxhin gjahtar, se ai do ta vrasë me pushkën e tij të gjatë.

The middle ribbon string is not tied
around the middle and the other ends hang off both
ends from the middle. Some need to be tied
around the middle.



valued relationship tends their own mission. She has not
relinquished her own mission, though. She is still
Ngjyros.

Dhia: Po ku ta gjejmë xhaxhin gjahtar, se?

Keci V: Me siguri ēshtë nē pyll. Unē po shkoj ta thërras xhaxhi gjahtarin sa nuk ēshtë bërë vonë. (*Dhe pa një pa dy, Keci V ikën me vrap*).

Dhia: Prit tē shkojmë sē bashku! (*Dhe me shpêjtësi nxjerr gershérët, perin e gjilpérën i fut nē xhep dhe, pa vonuar, del edhe ajo nga kasollja. Skena errësohet*).

AKTI – III –

(*Skena ndriçohet. Pamje pylli. Dëgjohet cicërima zogjsh përzier me gurgullimën e ujit. Në skenë hyjnë Dhia dhe Keci V. Duken tē lodhur*).

Keci V (Ofshan thellë): Uhaa! Sa jam lodhur!

Dhia: Epo i kemi rënë malit trup e térthor dhe xhaxhi gjahtar nuk qe askund.

Keci V: Nënë, tē ulemi e tē pushojmë pak.


Dhia: Ulemi, bir i nënës (*dhe ulen*).

Keci V (E vendos dorën mbi bark): Nënë, pa shih si më kërcasin zorrët.

Dhia: Uh, biri im, qenke i uritur. Eja tē pish pak qumësht tē gjirit tim.

Keci V (Fillon tē thithë gjirin e ëmës. Pastaj i inatosur i drejtohet s'ë ëmës): Nënë, nuk tē paska mbetur pikë qumështi (*dhe dënes*) ëëë.

Dhia (E brengosur): Uh, e mjera unë, më paskan shterruar gjinjtë. (*Dhe nē atë moment nga qielli zbret një vajzë e bukur me fletë shpendi. Dhia dhe Keci marrin tē ikin tē trembur. Ajo fluturon pas tyre*).



Ngjyros

Vajza me fletë shpendi (*Me zë të embël*): Mos u trembni, erdha t'ju ndihmoj.

Keci V (*I entuziazmuar*): E kush je ti?

Vajza me fletë shpendi: Unë jam Zana e pyllit.

Dhia dhe Keci (*Të çuditur*): Zana e pyllit?!

Dhia (*E çuditur, me zë të ulët*): Vërtet qenka e bukur si Zana!

Keci V (*Kureshtar*): E ç'a kërkon nga ne?!

Zana: Në fillim më thoni se ç'hall ju ka sjellë deri këtu, në thellësi të pyllit. Unë u ndihmoj të gjithë atyre që kanë nevojë.

Dhia (*E hamendur*): Po... ne kemi një hall të madh! Uh, s'po di nga t'ia filloj.

Keci V (*Ia pret fjalën*): Unë dua qumësht. (*I bie ballit me dorë*) Uh jo, unë dhe nëna kemi ardhur...

Zana (*Ia ndërpret fjalën*): Ngadalë, ngadalë. Ti, vocërrak, the se nuk ke pirë qumësht, domethënë je i uritur.

Keci V: Po, nënës i kanë shteruar gjinjtë.



Zana (*I ofrohet Kecit dhe e ledhaton*): Vogëlush, pi qumësht nga gjiri im, se...

Keci V (*Ia ndërpret fjalën, i trembur*): Si?! Çfarë?!

Zana: Po po, ti je i uritur. Nënës sate i kanë shteruar gjinjtë nga lodhja dhe frika, prandaj eja në gjirin tim e mos bëj naze.

Dhia (*E aftron Kecin Vafér Zanës*): Pije qumështin e Zanës, biri im, se je i uritur.

Keci V (*Fillon të thithë gjirin e Zanës. Për një çast e lë gjirin. Si duket, ngihet qumësht. Zana largohet fluturim e Keci, për çudi, fillon të rritet e të rritet e të bëhet i madh, një Kec i zhvilluar e me brirë të mëdhenj*):



Nyixos

Dhia (*Duke fshirë sytë, e çuditur, e shikon Kecin*): Vallë, a është e mundur, apo më bëjnë sytë?!

Keci V (*I çuditur, prek trupin e vet*): Ç'ndodhi kështu me mua?! Si u bëra kaq shpejt i madh dhe i zhvilluar, a!

Dhia (*Duke u menduar*): Me siguri qumështi i Zanës të rriti e të bëri të zhvilluar e të fortë si vigan. (*E përqafon e gëzuar*).

Keci vigan (*Fillon të kërcejë, por, si duket, i bie diçka ndër mend dhe ndalet*): Nuk më ka hije të vallëzoj pa vëllezërit e mi. (*Ofshan thellë*). Ah sikur ta gjeja tash ujkun, do ta vrisja e t'ua merrja hakun vëllezërve të mi!

Zana (*Nga lart*): Po, po, do ta marrësh hakun! Nuk ke nevojë për xhaxhi gjahtarin, po nisu drejt te përroska, atje është ujku.

Dhia dhe Keci vigan (*Së bashku*): Të falemnderit, moj Zanë. (*Vrapojnë pas Zanës duke e falënderuar. Zana ikën duke i përshëndetur. Ata dalin nga skena duke e përshëndetur Zanën. Skena errësohet*).

Pamja - II -

(*Skëna ndriçohet. Në thellësi natyrë e gjelbëruar pranverore. Dëgjohet gurgullima e ujit të përroskës, përzier me melodinë e bukur të zogjeve. Në anën e djathtë të skenës një humnerë, kurse pak më andej një grumbull gurësh të vegjël. Në mes të skenës një pus. Në skenë hyn ujku duke lëpirë buzët e duke fërkuar barkun.*)

Ujku: Hëk, sa mish të shijshëm kam ngrënë sot, kurre në jetë nuk kam ngrënë kësi mishi. Hëk, më ka rastisur të ha lloj-lloj mishrash, veçse mishi i Kecit qenka më i shijshmi... uhaa, s'paska me të, hëk! Si shkon uji pas mishit! (*Afro-*

Ngjyros



het te pérroska. Fillon tē pijë ujë. Në skenë, me hapa tē lehtë, hyn Keci vigan dhe shkon drejt pérroskës, disa metra përmbi ujkun e fillon t'ia turbullojë ujin me këmbë).

Keci vigan (*Me ironi*): Hej bebi, mos ma turbullo ujin.

Ujku (*Ngre kokën dhe sheh se një Kec po e vë në lojë çuditet. I drejtohet me zemërim*): Hej ti atje, prej kur na qenke bërë aq trim, sa tē marrësh guximin e tē ma turbulosh ujin mua.

Keci vigan (*Me guxim*): Prej sot, zotrote.

Ujku (*Me ironi*): Ohoo! Prej sot! (*I millefosur*) Tash do ta pësosh si vëllezërit e tu. (*Qesh me ironi, ha, ha, ha*).

Keci vigan (*I zemëruar*): Mos qesh, o i mallkuar. Unë tē shpall dyluftim, dhe do ta pësosh keq.

Ujku (*I çuditur*): Dyluftim! (*Qeshet, Ha, ha, ha...*)

Keci vigan (*I zemëruar*): Qeshu, bishë e egër, qeshu, por kjo do tē jetë qeshja jote e fundit. Më prit, se erdha! (*Dhe merr hov në drejtim tē ujkut. Edhe ujku i vërsulet, por Keci vigan si rrufe, me brirët e tij tē mëdhenj e tē mprehtë e godet në kokë dhe e rrëzon përdhe. Ujkut tē shtrirë, rrëth kokës i cicërojnë zogjtë. Ende pa u këndellur, Keci vigan i turret edhe disa herë duke e goditur me brirë, derisa ujku nis tē nxjerrë shkumë nga goja. Mbrapa skenës dëgjohen thirrjet e Dhisë*).

Dhia: Ooo, biri im, ku je, ku më humbe kaq shpejt?

Keci: Këtu jam, nënë. Eja, eja.

Dhia (*Hyn në skenë e çuditur, kur e sheh ujkun tē shtrirë, duke shkumuar nga goja. E përqafon Kecin vigan*).

Dhia (*E gëzuar*): Kush e vrau ujkun, or bir?

Keci vigan (*Paraqitet modest*): Nuk është me rëndësi. (*Me ironi*). Nënë, na duhet shpejt tē thërrasim një doktor, se po jep shpirt zotëria.



Ngjyros

Dhia (Me ironi): Të pastë nëna, mos u merakos fare për doktor, se vetë jam mjeke, kirurge. (*Dhe nxjerr nga xhepi gér-shérët*). Tash nëna e bën operacion. (*Dhia fillon t'ia hapë ujkut barkun me gérshérë. Pasi ia hap barkun, nxjerr një nga një të katër kecat. Ata, nga gëzimi, fillojnë të kércejnë*).

Dhia (E vë gishtin tregues tek hunda): Shsht! Qetësi, se mos e zgjoni këtë zotëri. Po shkoni shpejt, merrni gurë e t'ia mbushim barkun. (*Kecat me shpejtësi shkojnë te grumbulli i gurëve dhe secili merr nga një grusht. I sjellin gurët dhe ia hedhin ujkut në barkun e hapur. Pastaj Dhia, nga xhepi nxjerr gjilpërën me pe dhe ia qep barkun*).

Keci vigan: Unë them që këtë egërsirë ta hedhim në humnerë.

Dhia: Mirë thua, ta hedhim në humnerë që të mos na nxjerrë kurrë telashe.

Kecat (Së bashku me zë të lartë): Në humnerë, coftina e ka vendin në humnerë! (*Dhe Keci vigan e kap ujkun për këmbët e përparme, Dhia për këmbët e prapme, kurse katër kecat i ndihmojnë duke e mbajtur me duar. Afrohen pranë humnerës*).

Dhia: Ngadalë! Si duket po i lëviz qerpikët! Do të këndellet.

Keci vigan: Ta hedhim në humnerë.

Të gjithë: Ta hedhim (*Duke e luhatur*) një, dy, tre (*dhe e hedhin në humnerë. Nga thellësia e humnerës dëgjohet kli-thma e ujkut. Të gjithë së bashku kércejnë dhe brohorasin*) “Vdekje Ujkut”! Urraa! (*Nga largësia dëgjohet melodja e një valleje popullore me tupana e cylre*).

Keci I (Duke dëgjuar melodinë e valles): Kjo ditë është festë e madhe.

Najmros



Dhia: Epo, nē festa duhet tē kēndoymē e tē vallēzōjmē.

Keci vigan: Pra, tē vallēzōjmē rrēth pusit, deri nē mēngjes (tē gjithē kāpen dorē pēr dore dhe fillojnē tē vallēzōjnē rrēth pusit. Atē çast nē skenē hyn mullisi si gjahtar, me pushkē nē dorē).

Mullisi gjahtar (*I çuditur i shikon ata duke vallēzuar dhe i pyet*): Mos e keni parē ujkun, ku ẽshtë ajo bishë? Do ta vras.

Tē gjithē (*Duke qeshur*): Ha-ha-ha. Nē humnerë, o xhaxhi gjahtar, nē humnerë!

Mullisi gjahtar (*I gēzuar, pyet i çuditur*): Aa! Kush e vrou ujkun?!


Keci vigan (*Me modesti*): O xhaxhi, nuk ẽshtë me rēndësi, po eja e ta festojmē sē bashku vrasjen e kēsaj bishe tē mallkuar.

Mullisi gjahtar: Po pra, ta festojmē. Ju vallēzoni e unē po shkrep me pushkē. (*Dēgjohet krisma e pushkës: Bam. Duke vallēzuar, dalin nga skena. Skena errësohet nën tingujt e bukur tē valles popullore pērzier me ndonjë krismë pushke*).

Bie perdja

Keci vigan: Ta hedhim se ne doqimë.
Tē gjithë: Ta hedhim (duke e menjuar) nje, dy, tri (dhidhkim se humnerë doqimës e humnerës dëgjohet këma e ujkut. Të gjithë i fasin se njeqne dhjetorës së shpejtësirë) delje Ujkut i Grras (Nga largësia dëgjohet melodja e një illoje popullore me tupauna e vjetër).

Keci I (*Dale dëgjuar melodjinë e valles*): Kjo ditë eshtë tate e malie.



Najynas

Rexhep Tërshnjaku

KUSH E MBYTI UJKUN

Dramë për fëmijë

GRAPHICS & DESIGN




Tirazhi: 3000 copë

Shypur në shtypshkronjën

DE RADA

Prishtinë

2003



Rexhep Tërsinjaku u lind më 1968 në fshatin Plavë të Sharrit.

E kreu letërsinë dhe gjuhën shqipe në Fakultetin e Filologisë të Universitetit të Prishtinës. Studioi edhe aktrimin si dhe dramaturgjinë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Ka punuar në media të ndryshme të vendit, si gazetarë dhe folës. Merret me veprimitari të ndryshme artistike.

Jeton në Prishtinë.

Ky është libri i tij i parë përfémijë.

6
34

NJË DRAMË ME PËRMBAJTJE TË NGJESHUR TEMATIKE

Drama përfémijë "Kush e vru ujkun" e Rexhep Tërsinjakut, duke ndërtuar një përmbajtje nga elementet paradigmatike të përrallave homonime nga aspekti lotrar, ngrihet në vlerë cilësore të kësaj gjini, e cila për nga vëllimi ende i mungon hapësirës sonë.

Autori me shkaktësi ka zbritur në nivelin e moshës dhe të imaginatës së bujshme dhe të brishtë të fémijës, dhe ka ndërtuar një hallkë kompozicionale dramaturgjikë skenike, nga e cila trojton aspektë të ekzistencës, të kopshme për botën fémijërore, për ta afirmuar fisnikërinë, solidaritetin dhe shpirtgerësinë, por edhe për të tjerhequr vërejtjen se jetë nuk është vetëm lojë, por edhe sfidë e rezikshme, me të cilën mund të ballafaqohemi në çdo çast. Nga ana tjeter, ai nxit kurajon përfëvrim përfi lu kundërvënë së keqes përfi ta refuzuar dhe përfi lu kundërvënë dhunës me dhunë. Në dramë gjithashtu afirmohet mendjempractësia, trimëria dhe gjftësia përfi ta shquar të keqen, e cila jo rrallë shpërthen nën maskën e së mirës, siç paraqitet përmes personazheve simbolike të Ujkut dhe të Kecit. Të gjitha personazhet e dramës janë të individualizuara mirë, ndërsa veprimet janë të ngeshura në të gjitha linjat. Ideja është zhvilluar me shkaktësi, ndërsa mesazhet janë të qarta. Ndonsë drama i përket gjinisë letrare, vlera e saj verifikohet, sprovohet dhe manifestohet në mënyrën e plotë përmes realizimit skenik, andaj vlerat e saj të mirëfillta priten të manifestohen në një realizim të tillë. Kemi mbresën se drama "Kush e vru ujkun", me idetë, kuptimet dhe mesazhet përsiell shënon edhe një të arritur në fushën e dramaturgjisë sonë.

2 • VI

Prof. Dr. Nebi ISLAMI